



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

---

VENDIM

Nr. 7, Datë 30.07.2010

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- |                            |            |
|----------------------------|------------|
| - Znj. Anila Jani          | Kryetar    |
| - Z. Bashkim Sykja         | Nënkryetar |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtar     |
| - Znj. Ledina Mandia       | Anëtar     |
| - Z. Altin Goxhaj          | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 30.07.2010, mori në shqyrtim 2 publicitete te Albanian Airlines: i) Piza-Piza starting from 76 euro dhe ii) Tirana –London 39 euro + taxes.

Komisioni pas shqyrtimit të çështjes dhe degjimit te perfaqesuesve te shoqerise Albanian Airlines,

**VËREN SE:**

Keto publicitete nga menyra e tyre e formulimit, referuar nenit 15 te Ligjit nr.9902, date 17.04.2010, janë praktika te padrejta tregtare:

**pika 1**, sipas te cilit “Një praktikë tregtare është çorientuese kur, duke konsideruar të gjitha tiparet dhe rrethanat e saj, si dhe kufizimet e mjeteve të komunikimit, jep të mangët informacionin, që i nevojitet konsumatorit mesatar për të qenë i informuar për të marrë një vendim dhe, në këtë mënyrë, e bën apo ka mundësi ta bëjë konsumatorin mesatar të marrë një vendim, të cilin, në të kundërt, nuk do ta kishte marrë”.

**pika 4, paragrafi c**, si praktikë çorientuese, sipas të cilit “Në rastin e një ftese për blerje, nëse kjo nuk është e qartë nga konteksti, do të konsiderohet si thelbësor informacioni i mëposhtëm:

çmimi, që përfshin edhe taksat, ose mënyrën në të cilën llogaritet çmimi, kur natyra e mallit ose shërbimit është e tillë që nuk mundëson llogaritjen e arsyeshme paraprake të çmimit dhe, sipas rastit, të gjitha shpenzimet shtesë për transportimin, dorëzimin apo shpenzimet postare ose faktin e pagimit të shpenzime të tilla suplementare, kur ato nuk mund të llogariten arsyeshëm paraprakisht”;

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni mbështetur në nenin 15, pikat 1 dhe 4 (c), si dhe nenin 55 të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si dhe në pikën 6/c të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008

**VENDOSI :**

Kompania Albanian Airlines të ndaloje menjehere shkeljen dhe te marre te gjitha masat per ndreqjen e praktikave te tilla corientuese ne perputhje me kerkesat e ligjit nr.9902, dt 17.04.2010 “Per mbrojtjen e konsumatoreve”.

**KRYETAR I KOMISIONIT**



**ANILA JANI**